

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaLatex® Max

EMULSION I MODIFIKUAR PËR PËRMIRËSIMIN E LLAÇEVE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaLatex® Max është një aditiv me formulë të modifikuar për llaçet për gamë të gjerë aplikimesh në ndërtim, pa APEO. Është një dispersion ujor rrëshire sintetike në formën e një lëngu qumështor të përqëndruar me teksturë të pasur, që përdoret kryesisht për shtimin e ndërkapjes së llaçit mbi nënshtresë dhe për përmirësimin e vetive të tij.

PËRDORIMET

SikaLatex® Max përdoret në mikset e betonit dhe llaçeve për:

- Prodhim llaçesh për përmirësimin e ndërkapjes
- Shtresë e hollë & e ndërmjetme për finiturë
- Prodhim suvaje, llaçesh për veshje
- Llaçe për meremetim betoni
- Llaçet e dysHEMEVE
- Të gjitha llojet e llaçeve në ndërtim

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Në përputhje me rregulloren REACH (pa APEO)
- Përmirëson ndërkapjen e llaçeve mbi të gjitha nënshtresat, edhe mbi ato të lëmuara (beton, gur, tulla, metale ferroke, qelq dhe qeramika)
- Prodhon llaçe që janë lehtësisht të punueshëm për arsye të teksturës së modifikuar
- Kufizon rrezikun e plasaritjes dhe tkurrjes
- I bën llaçet më plastik dhe të aplikueshëm me lehtësi
- Përmirëson aftësinë hidroizoluese
- Përmirëson fortësinë e sipërfaqes
- Redukton konsumimin dhe mbledhjen e pluhurit
- Prodhon llaçe me rezistencë të shtuar ndaj abrazionit
- Përmirëson rezistencën kimike

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshira të përmirësuara stireni
Ambalazhi	kovë 1, 5 dhe 20 kg fuçi 210 kg IBC 1000 kg
Paraqitja / Ngjyra	Emulsion, i bardhë
Jetëgjatësia	18 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur në kushte të thata dhe i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrirja.
Dendësia	~ 1,0 kg/l (në +20 °C)
Vlera e pH	8,0 – 11,0 (në +20 °C)

TË DHËNA TEKNIKE

Receta e Ilaçit

Llaç për ndërkapje

Përbërës të thatë:

- 1 pjesë për vëllim çimentoje
- 1 pjesë për vëllim rëre

Tretësira SikaLatex® Max me ujë:

- 1:1 deri në 1:3 për vëllim SikaLatex® Max

Llaç për mbushje

Përbërës të thatë:

- 1 pjesë për vëllim çimentoje
- 3 pjesë për vëllim rëre

Tretësira SikaLatex® Max me ujë:

- 1:2 deri në 1:3 për vëllim SikaLatex® Max për llaçe të hidroizoluar
- 1:2 deri në 1:4 për vëllim SikaLatex® Max për llaçe ndërtimi
- 1:4 deri në 1:7 për vëllim SikaLatex® Max për aplikime të përgjithshme

Suva

Suvatë konsistojnë në lloje të ndryshme shtresash:

- Llaç për ndërkapje, si një shtresë ndërkapjeje, për të siguruar ankorimin mekanik me shtresat vijuese.
- Shtresë llaçi më e trashë
- Shtresë (më e hollë) përfundimtare llaçi

Aplikoni **l्लाçin për ndërkapje** (shin recetën e propozuar më sipër). Në vazhdim, aplikoni **shtresën më të trashë** duke përdorur tretësirën e SikaLatex® Max me ujë:

- 1:4 deri në 1:5 për vëllim SikaLatex® Max

Përfundoni suvatimin duke aplikuar **shtresën përfundimtare më të hollë**.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar

Në të gjitha rastet (shin recetën e llaçit), përzieni përbërësit e thatë dhe më pas shtoni tretësirën SikaLatex® Max me sasinë e kërkuar të ujit, derisa të prodhohet një miks homogjen me punueshmërinë e kërkuar.

Konsumimi

Në përgjithësi, 5-10% të peshës së çimentos në varësi të aplikimit.

UDHËZIME APLIKIMI

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Hapi 1: Shtoni produktin tek uji i përzierjes në përqindjen e specifikuar të hollimit për secilin lloj aplikimi.

Hapi 2: Përzieni përbërësit e thatë së bashku, shtoni hollimin në sasinë e kërkuar ndërsa përzieni të paktën për 90 sek. deri sa të prodhohet një miks homogjen me punueshmërinë e kërkuar.

KUFIZIME

- Nuk rekomandohet përdorimi i tretësirës SikaLatex® Max me ujë për shtimin e ndërkapjes, pa shtuar raportin e rekomanduar çimento:rëre.
- Për llaçet e prodhuara me SikaLatex® Max vlejnë të njëjtat rregulla të përgjithshme në lidhje me aplikim dhe trajtimin si për llaçet normale.
- SikaLatex® Max nuk duhet të shtohet në miksin e thatë të çimentos dhe agregateve.
- Raportet e lartpërmendura të përzierjes janë indikative. Konsumimi i SikaLatex® Max mund të ndryshojë në varësi të aplikimit.
- Përpara të gjitha aplikimeve, duhet të kryhen testime përshtatshmërie, sepse prodhimi i miksit më të mirë varet nga parametra të ndryshëm si cilësia e rërës,

temperatura, lagështia, etj.

- Duhet të zbatohen rregullat standarde në lidhje me prodhimin dhe aplikimin e llaçit. Referohuni tek standardet përkatëse. Llaçi i freskët duhet të trajtohet në mënyrën e duhur. Të mbrohet gjatë trajtimit nga ngrirja dhe tharja e parakohshme.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdo afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdo formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaLatex® Max
Gusht 2019, Botimi 02.01
020301010010000162

SikaLatexMax-sq-AL-(08-2019)-2-1.pdf

